


Florentina Dedushaj

Libër për mësuesin

Njeriu dhe natyra **2**



Libër për mësuesin

Njeriu dhe natyra **2**

ISBN: 978-9951-843-03-4



9 789951 843034

BOTIME

pegi

Florentina Dedushaj

LIBËR PËR MËSUESIN/EN

NJERIU DHE NATYRA 2

Për klasën e dytë të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2023



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t:
Korrektore letrare: Oriada DAJKO
Paraqitja grafike: Aida ÇELA
Kopertina: Florinda ZONJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-843-03-4

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, gusht 2023
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

PËRMBAJTJE

HYRJE	5
PLANI VJETOR	7
PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR	8
PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR	11
PLANI TREMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS	14
PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJI-QERSHOR.....	17
PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	19
TEST 1	77
TEST 2	79
REFERENCA	81

HYRJE

Të nderuar mësimdhënës/e,

Libri i mësuesit “Njeriu dhe natyra 1” do t’ju shërbejë si udhëzues për t’ju orientuar dhe për t’ju ndihmuar në planifikimin dhe realizimin e situatave të të nxënësve në klasë, duke iu mundësuar nxënësve përvetësimin dhe zbatimin gradual të kompetencave të shkallës së dytë të parapara në KK.

Organizimi i mësimi është përqendruar në atë çka duhet të dinë dhe në atë se çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit e këtij niveli. E gjithë kjo duhet të pasqyrohet përmes njohurive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet të reflektojnë. Lënda “Shkathtësi për jetë”, në klasën e pestë është e orientuar drejt përvetësimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për të ngritur vetëdijesim dhe vetëbesim për ushtrimin e punës praktike, përdorimin e TIK-ut, bashkëpunimin lidhur me ekonominë familjare, me mjedisin jetësor, këshillimin dhe orientimin në karrierë, si dhe puna dhe edukimi për ndërmarrësi.

Prej planifikimit të mirëfilltë në *Librin e mësuesit*, mësimi bëhet më atraktiv dhe më i kënaqshëm, përmes punës praktike, projekteve, aktiviteteve jashtë klase, hulumtimeve, lojërave, aktiviteteve të ndryshme praktike, në të cilat nxënësit nxiten që të marrin pjesë. Synimi kryesor në klasën e pestë është që nxënësit të identifikojnë interesimet e tyre për ndonjë veprimtari apo shkathtësi, siç janë: shkathtësitë duke përdorur pajisje të thjeshta teknike, përdor programe kompjuterike për krijimin e modeleve, si origami, *crafts* për punëdore, hulumton diversitetin ekologjik në mjedisin jetësor etj. Me përdorimin e TIK-ut, nxënësit do të aftësohen të gjejnë informacione nga një shumëllojshmëri burimesh, të përzgjedhin dhe të sintetizojnë informacionin për të përmbushur nevojat e tyre. Gjithashtu, ata do të jenë në gjendje të zhvillojnë idetë e tyre duke përdorur mjete të TIK-ut për të përmirësuar cilësinë, për ta ndryshuar dhe përsosur punën e tyre.

Kjo lëndë përfshin përpjekjet sistematike për të ndikuar në procesin e zhvillimit të nxënësve, të cilët, përmes procesit të të mësuarit, përdorin materiale të ndryshme, mjetet e punës që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive për jetë dhe punë. Lënda ndikon te fëmijët në zhvillimin e mendimit kritik, zhvillimin e aftësive për të zgjidhur probleme, nxitjen e kreativitetit, aftësinë prezantuese, rritjen e vetëbesimit dhe punën ekipore. Pra, planifikimi i procesit mësimor është bërë në mënyrë të integruar, duke mundësuar që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu dhe lidhshmërinë me situata jetësore, të kuptojnë në mënyrë sa më të plotë. *Libri i mësuesit* shtjellon strategjitë dhe teknikat e të pyeturit si elemente delikate gjatë orës mësimore, gjithashtu disa nga metodat, teknikat, aktivitetet e mësimdhënies që iu vijnë në ndihmë gjatë planifikimit dhe realizimit të situatave të të nxënësve, konkretisht që janë përdorur gjatë planifikimit të njësive mësimore në këtë libër.

Temat e shtjelluara duke u bazuar në librin e nxënësit janë:

1. Shkathtësi për jetë – punëdore
2. Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i crafts
3. Mjedisi dhe shëndeti
4. Ekonomia familjare
5. Karriera
6. Media

Libri i mësuesit, ashtu si edhe vetë teksti mësimor, janë hartuar duke pasur si synim mësimdhënien dhe të nxëniet bazuar në kompetenca. Njësitë mësimore janë kompozuar në mënyrë të tillë që përkufizimet dhe shprehjet e reja të jenë sa më të qarta. Për këtë shërbejnë ilustrimet, shembujt nga jeta e përditshme. Modelet për hartimin e këtij teksti mësimor janë përzgjedhur duke u bazuar në temat dhe rezultatet e lëndës të dhëna në programet lëndore për klasën e pestë, miratuar nga MASHT. Në planifikimin e njësive mësimore në librin e mësuesit/es janë përdorur metodologjitë në përputhje me kërkesat për implementimin e KK. I gjithë planifikimi bazohet në: mësimdhënie dhe nxënie, me nxënësin/en në qendër dhe gjithëpërfshirje; mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar; mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave dhe mësimdhënie e nxënie të diferencuar. Metodologjia e vlerësimit është bazuar në vlerësimin formues, duke menduar gjithmonë si të realizohet një vlerësim i vazhdueshëm i nxënësit/es.

Mësuesi/ja është i lirë t'i ndryshojë çdo gjë sipas nevojave të nxënësve. Çdo model, që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxëniet, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku ai/ajo jep mësim.

PLANI VJETOR

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE					Kontributi në rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës I Klasa: II	
GJYSMËVJETORI I PARË (I)			GJYSMËVJETORI I DYTË (II)			
SHTATOR-TETOR 9 orë	NËNTOR-DHJETOR 8 orë	JANAR-SHKURT-MARS 10 orë	PRILL-MAJ-QERSHOR 10 orë	I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 7	
Lënda: Njeriu dhe natyra	Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj	Marrëdhëniet jetësore	Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve.	Mjedisi natyror	II	Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ 1, 3, 4, 6, 8
	Marrëdhëniet jetësore	Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut	Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë	Dielli burim i jetës në tokë	III	Kompetenca e të nxënimit – Nxënës të suksesshëm 1, 2, 3, 4
					IV	Kompetenca për jetë, për punë dhe mjedis – Kontribuues produktiv 2, 3, 5, 6
					V	Kompetenca personale – Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 5, 6, 7
					VI	Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 6

PLANI DYMUJOR SHTATOR-TETOR

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Klasa: II

Tema mësimore: LËNDA, VETITË DHE PËRDORIMI I SAJ. MARRËDHËNIET JETËSORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT – KOMUNIKUES EFEKTIV

- I.1 Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet temës.
- I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
- I.4 Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një se një faqe tekst të shtypur.

II- KOMPETENCA E TË MENDUARIT – MENDIMI KREATIV

- II.1 Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
- II.4 Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
- II.8 Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III - KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
- III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

IV - KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet... etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

V - KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSH

- V.1 Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit ku jeton dhe vepron.
- V.2 Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta sin ë rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo festoon fitoren me dinjitet).

VI - KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

- VI.6 Shpreh mendim duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive,
Vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: 1.1.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj	Identifikon lëndën nga druri, plastika, xhami etj. në klasë, shkollë, shtëpi etj.	Materialet dhe vetitë e tyre (Zh)	9 orë	Mësimdhënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirje	Vlerësim i vazhdueshëm	Shoqëria dhe mjedisi	Libri bazë Njeriu dhe natyra 2
	Dallon lëndët ushqimore për nga shija, vetia, përbërja etj.	Shija dhe vetitë e ushqimeve (Zh)		Mësimdhënie të bazuar në qasjen e integruar	Vlerësim motivues	Gjuhë shqipe	Fletore pune 2
	Përshkruan lëndët higjienike që përdor në jetën përditshme.	Lëndët higjienike (Zh)		Mësimdhënie të bazuar në arrijtjen e kompetencave	Lista e kontrollit	Matematikë	Burime të ndryshme nga interneti
	Dallon tri gjendjet agregate të ujit.	Tre gjendjet agregate të ujit (Zh)		Mësimdhënie e diferencuar	Informata kthyesë	Shkathësi për jetë	https://www.youtube.com/watch?v=92-q_6KQEpQ
	Gjen trupat e rregullt dhe të parregullt në mjedisin ku jetojnë.	Trupat e rregullt dhe trupat e parregullt (Zh)			Portofolio	Çështje ndërkurrikulare arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm	https://www.youtube.com/watch?v=L-crRQLn-p0
Marrëdhëniet jetësore	Tregon përbërësit kryesor të ajrit dhe kupton ndikimin e ajrit të pastër për shëndetin.	Ajri dhe shëndeti (Zh)			Diskutime	Edukim për paqe*	https://www.youtube.com/watch?v=340M-muYosY
	Përshkruan rëndësinë e mjedisit të pastër për qeniet e gjalla.	Sa kam përparuar në këtë temë mësimore (U)			Punë praktike		https://www.youtube.com/watch?v=Br4sQmjl1jU
		Orë në dispozicion të mësimdhënësit			Prezantime		https://www.youtube.com/watch?v=HQIpr8x-9VPU

PLANI DYMUJOR NËNTOR-DHJETOR

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Klasa II

Tema mësimore: MARRËDHËNIET JETËSORE

SHËNDETI, SJELLJET DHE EMOCIONET E NJERIUT

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

I - KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT – KOMUNIKUES EFEKTIV

- I.1 Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet temës.
- I.2 Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje – rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
- I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
- I.7 Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.

II - KOMPETENCA E TË MENDUARIT – MENDIMI KREATIV

- II.1 Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
- II.3 Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
- II.6 Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën në një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse.

III - KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS TË SUKSESSHËM

- III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

IV- KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.3 Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
- IV.6 Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta (të shëndetshme) dhe anasjelltas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

V - KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

- V.1 Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit të vet në të cilin jeton dhe vepron.
- V.3 Bën një listë (me njërën nga format shprehëse, si, shkrim, vizatim etj.) me ushqime, të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.
- V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
- V.6 Tregon mënyrat e zgjedhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.

VI - KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

- VI.4 Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: 1.2, 1.3

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Marrëdhëniet jetësore	- Identifikon disa nga kafshët që jetojnë në ujë, tokë dhe atmosferë. - Dallon rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm për njeriun. - Dallon ndryshimet biologjike të brendshme dhe të jashtëm ndërmjet dy gjinive. - Dallon ndryshimet trupore në mes dy gjinive. - Përdorë fjalë korrekte për pjesët e trupit dhe funksionin e tyre. - Kontrollon trupin e vet dhe kujdeset për higjienën trupore - Identifikon ndryshimet në trupin e vet dhe në rast nevojë kërkon ndihmë - Tregon tolerancë dhe mirëkuptim në situata të ndryshme - Ndërron kontakte sociale dhe krijon shoqëri në grupe shoqërore.	Kafshët jetojnë në vende të ndryshme (Zh) Ushqimi dhe shëndeti (Zh) Trupi ynë (Zh) Si ndryshon trupi im? (Zh) Higjiena personale (Zh) Sjellja e mirë na nderon (Zh) Sa kam përparuar në këtë temë mësimore (U) Test vlerësues në fund të gjysmëvjetorit të parë	8 orë	- Mësimdhënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen. - Mësimdhënie të bazuar në qasjen e integruar - Mësimdhënie të bazuar në arrijen e kompetencave - Mësimdhënie e diferencuar	Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim motivues Lista e kontrollit Informata kthyes Portofolio Detyra të shtëpisë Diskutime Punë praktike Prezantime Test Hulumtimi Eksperimentimi	- Shoqëria dhe mjedisi - Gjuhë shqipe - Matematikë - Shkathësi për jetë - Edukatë figurative - Çështje ndërkurrikulare arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm - Edukim për media - Arsim i qëndrueshëm	Libri bazë Njeriu dhe natyra 2 Fletore pune 2 Burime të ndryshme nga interneti https://www.youtube.com/watch?v=Gw-wKxEyDso https://www.youtube.com/watch?v=AvBUo-Pr-Qj4
Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut							

PLANI TREMUJOR JANAR-SHKURT-MARS

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Klasa: II

**Tema mësimore: TRUPAT KRYEJNË LLOJE TË NDRYSHME TË LËVIZJEVE
BURIMET E ZËRIT, DRITËS DHE NXEHTËSISË NË RRETHINËN TONË**

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

I - KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT – KOMUNIKUES EFEKTIV

- I.1 Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet temës.
- I.2 Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje – rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
- I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

II - KOMPETENCA E TË MENDUARIT – MENDIMI KREATIV

- II.1 Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
- II.4 Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvatësinë midis tyre.

III - KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS TË SUKSESSHËM

- III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.

IV - KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet... etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

V - KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

- V.2 Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen a standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta sin ë rastet e fitorës apo të humbjes (pranon humbjen apo festoon fitoren me dinjitet).

VI - KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

- VI.1 Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet, apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshtarët.
- VI.2 Diskuto në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
- VI.3 Arsyeto nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: 1.4, 1.5

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve	- Dallon gjendjen e lëvizjes së trupave nga gjendja e qetësisë me shembuj nga përditshmëria. - Tregon shembuj të lëvizjes së trupave me rënie, ngritje, hedhje, shkelmim, shpyrje, tërheqje etj. - Gjen shembuj nga lojërat, për lëvizje nëpër rrugë të drejtë, rrugë rrethore dhe lëvizje lëkundëse. - Emërton trupa që lëvizin në tokë, në ujë dhe në ajër. - Dallon dhe emërton trupa dhe gjallesa sipas shpejtësisë së lëvizjes së tyre. - Demonstron përfitimim e zërit nga burimet e ndryshme. - Emërton burimet e ndryshme të dritës të çfarëdo lloji. - Tregon burimet të nxehtësisë të jetës së përditshme, të ngurtë, të lëngët dhe të gazit	Lëvizja e trupave (Zh) Lëvizje të thjeshta (Zh) Lloje të tjera lëvizjesh (Zh) Ku lëvizin trupat? (Zh) Cili lëviz më shpejt? (Zh) Si prodhohet tingulli? (Zh) Burimet e dritës (Zh) Burimet e nxehtësisë (Zh) Sa kam përparuar në këtë temë mësimore (U) Orë në dispozicion të mësimdhënësit	10 orë	- Mësimdhënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen. - Mësimdhënie të bazuar në qasjen e integruar - Mësimdhënie të bazuar në arritjen e kompetencave - Mësimdhënie e diferencuar	Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim motivues Lista e kontrollit Informata kthyesë Portofolio Detyra të shëpisë Diskutime Punë praktike Prezantime Test Hulumtimi Eksperimentimi	- Shoqëria dhe mjedisi - Gjuhë shqipe - Matematikë - Shkathësi për jetë - Edukatë figurative - Çështje ndërkurrikulare arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm - Edukim për media - Arsim i qëndrueshëm	Libri bazë Njeriu dhe natyra 2 Fletore pune 2 Burime të ndryshme nga interneti https://www.youtube.com/watch?v=9IebRS6QbAE https://www.youtube.com/watch?v=Z5TkvvKqyA What is Light Energy? Learn About Light Waves & Light Sources! *Science for Kids* - YouTube I See the Light! - A Song about Light Sources - YouTube Sources of Heat - YouTube
Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë							

PLANI TREMUJOR PRILL-MAJ-QERSHOR

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Klasa: II

Tema mësimore: MJEDISI NATYROR. DIELLI BURIM I JETËS NË TOKË

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

I - KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT – KOMUNIKUES EFEKTIV

- I.1 Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet temës.
- I.2 Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje – rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
- I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
- I.7 Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.

II - KOMPETENCA E TË MENDUARIT – MENDIMI KREATIV

- II.3 Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
- II.4 Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvatësinë midis tyre.
- II.8 Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III - KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS TË SUKSESSHËM

- III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.

IV - KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS - KONTRIBUES PRODUKTIV

- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme(materiale, mjetet ...etj) dhe i përdorë në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

V - KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

- V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

VI - KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

- VI.2 Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
- VI.6 Shpreh mendim duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: 1.6,

Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Mjedisi natyror	- Përshkruan tokën si burim të të mirave materiale. - Dallon relievin, klimën, ujërat në tokë përmes vizatimit përkatësisht fotografive. - Identifikon ndotësit themelor të mjedisit si: mbeturinat, fabrikat, automjetet, ujërat e zeza. - Përshkruan dallimin mes fushës, kodrës dhe malit. - Tregon rolin e diellit, ajrit dhe ujit për jetën në tokë. - Përshkruan ndryshimin e klimës gjatë stinëve të vitit dhe krijimin e ditës dhe natës.	Toka ku jetojmë (Zh) Dielli, uji dhe ajri na japin jetë (Zh) Njohim tokën ku jetojmë (Zh) Ujërat në tokë (Zh) Ndotësit e mjedisit (Zh) Stinët e vitit (Zh) Dita dhe nata (Zh) Sa kam përparuar në këtë temë mësimore (U) Orë në dispozicion të mësimdhënësit (Pastrimi i oborrit të shkollës) Test vlerësues në fund të gjysmëvjetorit të dytë	10 orë	Mësimdhënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen. Mësimdhënie të bazuar në qasjen e integruar Mësimdhënie të bazuar në arritjen e kompetencave Mësimdhënie e diferencuar	Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim motivues Lista e kontrollit Informata kthyesë Portofolio Detyra të shtrëpisë Diskutime Punë praktike Prezantime Test Hulumtimi Ekspërimetimi	- Shoqëria dhe mjedisi - Gjuhë shqipe - Matematikë - Shkathësi për jetë - Edukatë figurative - Çështje ndërkurrikulare - arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm - Edukim për paqë*	Libri bazë Njeriu dhe natyra 2 Fletore pune 2 Burime të ndryshme nga interneti https://www.youtube.com/watch?v=CfMNgS0D0Sc https://www.youtube.com/watch?v=Wt-CRKsTYGs https://www.youtube.com/watch?v=wQnCyCAF_BY
Dielli burim i jetës në tokë							

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon lëndë të ndryshme si druri, plastika, xhami; në klasë, shkollë, shtëpi etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II. 1, 4, VI.6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Materialet dhe vetitë e tyre			
Fjalët kyçe: material, veti, druri, qelqi, plastika, metali, i fortë, i thyeshëm, i lehtë, i rëndë.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>identifikon katër objekte sipas përbërjes;</i> - <i>krahason katër objekte sipas llojit të materialit;</i> - <i>analizon të katër materialet sipas vetive të tyre.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, objekte prej materialesh të ndryshme, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Kërkohet nga nxënësit/et që të vështrojnë objektet që gjenden brenda klasës. Pasi t'i kenë identifikuar u parashtrohet pyetja: Nga cili material përbëhen këto objekte? Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i shkruan në tabelën e ndarë në kolona:			
Druri	Plastika	Qelqi	Metali
Plotësohen përgjigjet e nxënësve sipas nevojës. Njoftohen nxënësit/et me njësinë e re mësimore.			
HAPI II: Përmes projektorit paraqitet faqja 6 e librit. Diskutohet rreth figurave të paraqitura. Tregohen vetitë e ndryshme të secilit material, duke i demonstruar edhe me objektet e pranishme në klasë. Udhëzohen nxënësit/et që të vëzhgojnë figurën 4, përmes pyetjeve nxitën nxënësit/et që të emërtojnë disa nga objektet e paraqitura dhe pastaj diskutohet për materialet e tyre. Cilat objekte i shohim në figurë? Nga cili material janë të ndërtuara këto objekte?			

Cili material është i rëndë?

Cili material është i thyeshëm?

Marrim përgjigje nga nxënësit/et, plotësohen përgjigjet e tyre duke dhënë informacione shtesë mbi materialet dhe vetitë e tyre.

HAPI III:

Mësuesi/ja sjellë në klasë disa objekte (si: gota apo shishe qelqi, gota apo shishe plastike, lugë druri, lugë metali, lodra plastike, materiale tjera shkollore) të cilat i prezanton para nxënësve, duke u kërkuar që t'i grupojnë sipas llojit të materialit.

Pas grupimit të objekteve, nxënësve të ndarë në grupe u përcaktohet njëri grup i objekteve sipas materialit si: druri, metali, plastika, apo qelqi dhe udhëzohen që të shkruajnë për vetitë e atij materiali.

Secili grup prezanton punën e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve, shkrimin e vetive të materialeve

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.4

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon lëndët ushqimore për nga shija, vetia, përbërja etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.3,4.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shija dhe vetitë e ushqimeve			
Fjalët kyçe: e ëmbël, e kripur, e thartë, djegëse.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>identifikon shijen e mollëve përmes shijimit;</i> - <i>argumenton me disa fjalë rëndësinë e ushqimeve të shumëllojshme për shëndetin;</i> - <i>dallon llojin e shijeve të ushqimeve përmes të shijuarit;</i> - <i>lidh etiketat me fjali me fotografitë përkatëse.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, ushqime të ndryshme.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm, Gjuhë shqipe.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja sjell në klasë dy lloje të mollëve të kuqe dhe të gjelbra. Nxënësit u shpërndan nga një pjesë të secilës mollë. Pasi t'i kenë ngrënë u parashtron pyetje: - Cila mollë ju pëlqeu më shumë? - Cili ishte dallimi mes tyre? Merren përgjigjet e nxënësit, plotësohen nga ana e mësuesit/es për të dal te njësia e re mësimore. Në tabelë shkruhen fjalitë: - Ushqimet janë të shumëllojshme. - Ato kanë shije dhe aroma të ndryshme.			
HAPI II: Përmes projektorit paraqitet faqja 8 e librit dhe diskutohet rreth ushqimeve të ndryshme të paraqitura në figurë. - Cilat nga ushqimet po shohim? - Si i dallojmë nga njëri-tjetri?			

Lexohet njësia mësimore nga mësuesi/ja. Pastaj parashtrohen pyetjet në tabelë:

- Çfarë shijesh mund të kenë ushqimet?
- Pse duhet të hamë ushqime me shije të ndryshme?

Diskutimi zhvillohet rreth këtyre pyetjeve, ku secili nxënës/e përfshihet në diskutim duke treguar shijet e ushqimeve të ndryshme dhe argumentuar pse duhet të hamë ushqime me shije të ndryshme.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në libër. Ku nxënësit/et në dyshe do të provojnë ushqimet e sjella në klasë me sy të mbyllur. Njëri mbyll sytë, tjetri ia ofron ushqimin që ta tregojë shijen që ka.

HAPI III:

Nxënësve u shpërndahen etiketa ku janë të paraqitura ushqime të ndryshëm dhe fjalët e ëmbël, e kripur, e thartë, djegës, të cilat duhet t'i bashkojnë sipas shijes përkatëse.



e ëmbël

i thartë

e kripur

djegës

Disa nga nxënësit/et prezantojnë punën e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Angazhimi i nxënësve në diskutim, saktësia e lidhjes së etiketave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.5

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan lëndët higjienike që përdorë në jetën e përditshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,4; V.1.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Lëndët higjienike			
Fjalët kyçe: sapun, shampo, pastë dhëmbësh, detergjent.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - identifikon mjetet që përdorë për higjienën e trupit; - përshkruan mjetet higjienike sipas përdorimit të tyre; - shpjegon rëndësinë e larjes së duarve me ilustrim.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori, fletë pune.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Arsimitimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Udhëzohen nxënësit/et që të mbyllin sytë dhe të mendojnë për gjërat që kanë bërë në shtëpi para se të vinin në shkollë. Disa nga nxënësit/et tregojnë rutinën e tyre ditore. Pastaj u paraqiten pyetje si: Me çfarë e pastrojmë tabelën? Po bankat dhe dyshtemenë? Mësuesi/ja sqaron që, për pastrimin e trupit dhe të mjedisit përdorim ujë dhe disa lëndë higjienike.			
HAPI II: Lexohet njësia mësimore f.10 me paragrafë nga disa nxënës/se të ndryshëm. Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësve u paraqiten pyetje për të diskutuar rreth lëndëve higjienike dhe përdorimit të tyre. Me çfarë lajmë duart dhe fytyrën? Po kokën dhe trupin? Çfarë përdorim për larjen e dhëmbëve? Kur duhen larë dhëmbët? Çfarë përdorim për pastrimin e mjedisit? Pse duhet të kemi kujdes gjatë përdorimit të lëndëve higjienike? Pas marrjes së përgjigjeve nga nxënësit/et, udhëzohen që të vëzhgojnë figurën 4 të paraqitur në libër dhe të lidhin me shigjetë mjetet se për çfarë përdoren.			
HAPI III: Përmes projektorit paraqitet videoja e pastrimit të duarve në 10 hapa. https://www.youtube.com/watch?v=Br4sQmiJ1jU			

Pas shikimit, disa nga nxënësit/et tregojnë atë që shikuan duke praktikuar larjen e duarve.

Nxënësve u shpërndahet fleta e punës, të cilën do ta presin dhe ngjyrosin, ku do të kuptojnë më mirë rëndësinë e larjes së duarve.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve, punën praktike.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.6, praktikimi i larjes së duarve.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon tri gjendjet agregate të ujit	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,4; III.2.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Tri gjendjet agregate të ujit			
Fjalët kyçe: i ngurtë, i lëngët, i gaztë, gjendje agregate, akull, avull.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>dallon tri gjendjet e ujit në natyrë;</i> - <i>përshkruan qarkullimin e ujit në natyrë sipas udhëzime;</i> - <i>vendos katër etiketat me fjalë në ilustrimin e dhënë.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori, fletë A4.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Përmes projektorit paraqitet videoja ku shpjegohen tri gjendjet agregate të ujit. https://www.youtube.com/watch?v=92-q_6KQEpQ Pas shikimit, pyetën nxënësit/et: - Si gjendet uji në natyrë? Mësuesi/ja shkruan në tabelë: Uji gjendet në tri forma: i ngurtë, i lëngët, i gaztë.			
HAPI II: Lexohet mësimi f.12 me paragrafë dhe pas leximit të çdo paragrafi nxënësve u parashtrihen pyetje për të nxitur diskutimin në klasë. - Çfarë ndodh me ujin kur ngrinë? - Çfarë janë akullnajat? - Si është uji? - Si kthehet uji në gjendje të gaztë? Pas secilës pyetje merren përgjigjet e dy-tre nxënësve. Pyetën nxënësit/et: - E dini si qarkullon uji në natyrë?			

Këtë do ta shohim edhe përmes videos që do ta shikojmë tani.

<https://www.youtube.com/watch?v=s0bS-SBAGJI>

Pas shikimit të videos, disa nxënës/e ritregojnë qarkullimin e ujit në natyrë.

Pastaj u kërkohet që të vëzhgojnë figurën në libër diskutohet rreth saj dhe së bashku plotësojmë etiketat e zbrazëta në libër.

HAPI III:

Realizohet veprimtaria e paraqitur në libër, “Uji në natyrë”.

Nxënësve u shpërndahet nga një fletë ku është paraqitur mjedisi dhe ata duhet të vendosin etiketat në vendet e duhura bazuar dhe në shembullin e paraqitur në libër, gjendjet e ujit në natyrë.



Dielli nxeh Tokën dhe ujin

Nga retë bie shi

Në qiell është ftohtë, uji bëhet re

Uji avullohet dhe ngritët lart

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve gjatë diskutimit dhe vendosjen e saktë të etiketave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.7


REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj		Rezultati i të nxënësve të temës: Gjen trupat e rregullt dhe të parregullt në mjedisin ku jeton.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: I.3; II.4; IV.5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Trupat e rregullt dhe trupat e parregullt			
Fjalët kyçe: trup, trupa të rregullt, trupa të parregullt.			
Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon trupat e rregullt dhe të parregullt në mjedisin; - gjen dallimet dhe ngjashmëritë e dy objekteve; - liston trupa të rregullt dhe të parregullt në tabelë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, guri, fletorja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm, Gjuhë shqipe.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja para nxënësve prezanton dy trupa të ndryshëm si librin dhe gurin. U shpjegon nxënësve që të dy janë trupa dhe secili prej tyre zë një vend të caktuar në hapësirë.			
			
Pastaj pyet nxënësit/et: Nga <i>farë</i> dallojnë këta trupa? Marrim përgjigje nga nxënësit/et, vazhdojmë me nënpyetje nëse nuk marrim përgjigjen e duhur. Përgjigjet plotësohen nga mësuesi/ja për të shpjeguar që trupat të cilët kanë formë të rregullt janë trupa të rregullt, ndërsa trupat që nuk kanë formë të rregullt quhen trupa të parregullt.			
Hapi II: Lexohet njësia mësimore f.14. Diskutohet rreth figurave të paraqitura në libër për të përcaktuar formën e tyre. Pastaj pyetën nxënësit/et për figurën e radhës:			

Çfarë kanë të ngjashme dollapi dhe çanta? Nga se ndryshojnë?

Diskutojmë dhe plotësojmë diagramin e Venit.



Lexohen ndryshimet dhe ngjashmëritë e dollapit dhe çantës nga disa nxënës/e.

Hapi III:

Realizohet veprimtaria e paraqitur në libër, “Grupojmë trupat”.

Zgjidhni disa trupa që gjenden në klasë, ndajini në dy grupe: trupa të rregullt dhe trupa të parregullt.

Më pas plotësoni tabelën.

Trupa të rregullt	Trupa të parregullt

Disa nga nxënësit/et lexojnë trupat që kanë përshkruar në kolonat përkatëse.

VLERËSIMI I NXËNËSVE


Vlerësohen nxënësit/et në plotësimin e saktë të diagramit dhe tabelës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.8

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Lënda, vetitë dhe përdorimi i saj		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon përbërësit kryesor të ajrit dhe kupton ndikimin e ajrit të pastër për shëndetin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; V.2.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ajri dhe shëndeti			
Fjalët kyçe: ajër, gaz, oksigjen, shëndet.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - shpreh dy ose tri mendime për ajrin; - diskuton bazuar në ilustrim për rëndësinë e ajrit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori, balona.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm, Shoqëria dhe mjedisi			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Nxënësve u parashtronet pyetja: Çfarë dini për ajrin? Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën ajri dhe e plotëson me mendimet e nxënësve. 			
HAPI II: Nxënësit/et lexojnë njësinë mësimore f.16. Pastaj mësuesi/ja parashtron pyetjet: - Çfarë përmban ajri? - Çka është oksigjeni? - Kush e dëmton shëndetin? Diskutohet bashkërisht rreth këtyre pyetjeve. Udhëzohen nxënësit/et t'i shikojnë figurat dhe diskutojmë rreth tyre përmes pyetjeve të parashtruara. - Përse janë të dobishme pemët? - A është i drejtë veprimi i njeriu në figurën e parë? - Pse fëmijët, në figurën e dytë, mbajnë maska në fytyrë?			

HAPI III:

Pas diskutimit të rëndësisë së pemëve në mjedis, përmes projektorit paraqitet një video rreth 3 minuta ku tregon që qeniet e gjalla nuk mund të jetojnë pa ajër.

<https://www.youtube.com/watch?v=HQTpt8x9VPU>

Pas shikimit të kësaj videoje realizohet veprimtaria “Luajmë me tullumbace”.

Nxënësit/et fryjnë tullumbacet dhe luajnë me to brenda klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit në dhënien e përgjigjeve gjatë diskutimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.9

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Marrëdhëniet jetësore		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan rëndësinë e mjedisit të pastër për qeniet e gjalla.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,7; IV. 6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mjedisi ku jetojmë			
Fjalët kyçe: mjedis, gjallesë, ndotje			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>identifikon tri pjesët kryesore të mjedisit jetësor;</i> - <i>përshkruan rëndësinë e tri figurave ku paraqitet mjedisi;</i> - <i>shkruan katër këshilla për një mjedis të pastër.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori, fletorja, lapsi.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja përmes projektorit paraqet para nxënësve hapësira mjedisore si: tokë, ujë ajër. Pyet nxënësit/et: - <i>Si quhen këto hapësira?</i> - <i>A zhvillohet jeta në to?</i> Diskutohet së bashku me nxënës/e rreth pamjeve përmes pyetjeve duke shkruar në tabelë përgjigjet e tyre në formë kllasteri, ku njoftohen nxënësit/et se do të mësojnë më shumë për mjedisin ku jetojmë.			
<			

- *Si duket mjedisi në figurën e dytë?*
- *Çka shkakton mjedisi i ndotur?*

Marrim përgjigje nga nxënësit/et, kërkohet të vëzhgojnë edhe figurën e radhës dhe diskutohet përmes pyetjeve:

- *Si mund të kujdesemi për mjedisin?*
- *Si kujdeseni ju për mjedisin?*
- *Pse duhet ta mbajmë mjedisin pastër*

Nxënësit/et japin përgjigjet e tyre në pyetjet e parashtruara, më pas kërkohet nga nxënësit/et të shkruajnë në fletore katër këshilla se si duhet ta mbajmë ambientin e pastër. Lexohen disa nga këshillat e nxënësve.

Hapi III:

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et që të marrin me vete fletoren dhe lapsin, të dalin në oborrin e shkollës dhe të shikojnë përreth dhe të shkruajnë në fletore ndotjet që vunë re.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet angazhimi i nxënësve në dhënien e përgjigjeve, për shkrimin e këshillave

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune faqe 10

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE															
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II												
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut		Rezultati i të nxënës të temës: Kontrollon trupin e vet dhe kujdeset për higjienën trupore; Identifikon ndryshimet në trupin e vet dhe në rast nevojë kërkon ndihmë.													
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, III.3; V.1															
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3															
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE															
Njësia mësimore: Higjiena personale															
Fjalët kyçe: kujdesem, i pastër, i rregullt, parandaloj, mikrobe, ndihmë.															
Rezultatet e të nxënës të orës mësimore: Nxënësi/ja: - tregon pesë raste si kujdeset për trupin; - identifikon tri pasoja nga papastërtia; - identifikon ndryshimet e mundshme në trupin e vet; - demonstron drejt larjen e dhëmbëve.															
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, furçë dhëmbësh, paste dhëmbësh, kukulla															
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm															
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE															
HAPI I: Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin, “Higjiena personale”. Pyet nxënësit: <i>Si kujdeseni ju për higjienën personale? Çfarë ndodh me trupin tone nëse nuk e mbajmë higjienë trupore?</i> Njohuritë që nxënësit/et kanë për higjienën personale i shkruan në tabelë te rubrika Di .															
<table><tr><th>Di</th><th>Dua të di</th><th>Mësova</th></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>				Di	Dua të di	Mësova									
Di	Dua të di	Mësova													
Pastaj pyet nxënësit/et se çfarë duan të din më shumë për higjienën. Pyetjet e tyre i shkruan te rubrika Dua të di .															

HAPI II:

Udhëzohen nxënësit/et t'i hapin librat f.12 dhe të lexojnë njësinë mësimore.

Pasi të kenë lexuar, së bashku me nxënës/e plotësohet edhe rubrika **Mësova**.

Pastaj kërkohet nga nxënësit/et që të vëzhgojnë figurat e paraqitura në libër me veprimet që kryejnë fëmijët, poshtë tyre duhet shënuar V për veprimet që kryejnë edhe nxënësit/et. Përmes pyetjeve diskutohet rreth këtyre veprimeve.

Kur duhet pastruar duart?

Si kujdeseni për flokët tuaj?

Çfarë ndodh me ne nëse nuk mbajmë higjienën trupore?

Nëse gjatë lojës lëndoheni dhe vëreni ndonjë ndryshim në trupin tuaj, si veproni?

Kujt i drejtoheni?

Mësuesi/ja jep disa këshilla se si duhet vepruar në situata të tilla.

HAPI III:

Mësuesi/ja sjellë në klasë mjetet për të praktikuar mënyrën e larjes së dhëmbëve.

Te kukulla praktikohet larja e dhëmbëve duke iu demonstruar nxënësve larjen e drejt të dhëmbëve.

Kjo veprimtari praktikohet edhe nga disa nxënës/e.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et për angazhimin në dhënien e përgjigjeve, plotësimin e tabelës

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f16

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE									
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II						
Tema: Marrëdhëniet jetësore		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon disa nga kafshët që jetojnë në ujë, tokë dhe atmosferë							
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; V.5									
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2									
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE									
Njësia mësimore: Kafshët jetojnë në vende të ndryshme									
Fjalët kyçe: nevojë, tokë, ujë, ajër, ushqim, të vegjlit.									
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>identifikon tri mjediset jetësore të kafshëve;</i> - <i>krahason dy mjedise jetësore për rritjen e kafshëve;</i> - <i>përcakton mjedisin jetësor të gjashtë kafshëve.</i>									
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fletë A4, etiketa.									
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.									
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE									
HAPI I: Mësuesi/ja iu drejton pyetje nxënësve në lidhje me njësinë paraprake: - <i>Cilat ishin pjesët më të rëndësishme të mjedisit?</i> Mësuesi/ja nga përgjigjet e nxënësve shkruan në tabelë mjediset duke i ndarë në kolona:									
<table><tr><td>Toka</td><td>Uji</td><td>Ajri</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>				Toka	Uji	Ajri			
Toka	Uji	Ajri							
Më pas për të dalë te njësia e re mësimore vazhdon me pyetjen: - <i>Kush jeton në këto mjedise?</i> Marrim përgjigje nga nxënësit/et, vazhdon me pyetjet si: - <i>Cila është kafsha e preferuar e juaja?</i> - <i>Në cilin mjedis jeton ajo?</i> Pas përgjigjeve të disa nxënësve/ve shkruan emrat e kafshëve në kolonën përkatëse. Paraqitet njësia e re mësimore, kërkohet nga nxënësit/et që t`i hapin librat f.18. f.22									
HAPI II: Lexohet njësia mësimore me paragrafë duke i diskutuar edhe figurat e paraqitura në libër, theksohet që “për t`i plotësuar nevojat e tyre, kafshët jetojnë në mjedise të ndryshme”. Kërkohet nga nxënësit/et që t`i vështrojnë figurat e mjedisit jetësor të xhunglës dhe shkretëtirës dhe i diskutojmë ato së bashku.									

Pastaj mësuesi/ja u parashtron nxënësve pyetje për njohuritë e marra nga leximi.

- *Ku jetojnë kafshët?*
- *Pse kafshët e zgjedhin mjedisin ku do të jetojnë?*

Nxënësit/et japin përgjigjet e tyre në pyetjet e parashtruara.

HAPI III:

Mësuesi/ja nxënësve të organizuar në grupe u shpërndanë nga një fletë A4 për secilin grup, në të cilën janë paraqitur mjediset jetësore (toka, uji, ajri), grupeve u jepen dhe etiketa me emra kafshësh të cilat duhet t'i vendosin në mjedisin përkatës. Secili grup prezanton punën e tyre përmes përfaqësuesit të tij.

Diskutohet rreth mjediseve jetësore të kafshëve dhe nevojave të tyre për rritje e ushqim.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim në dhënien e përgjigjeve, bashkëpunimi në grup dhe përcaktimi i mjediseve jetësore të kafshëve

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Veprimtaria- Krijimi i mjediseve për jetesën e kafshëve; Fletore pune f.11

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Marrëdhëniet jetësore		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm për njeriun	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, 3; V.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ushqimi dhe shëndeti			
Fjalët kyçe: ushqime të shëndetshme, ushqime jo të shëndetshme, uji			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - gjen pesë ushqime të shëndetshme dhe jo të shëndetshme; - dallon rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm për njeriun; - arsyeton me tri mendime mënyrën e të ushqyerit të shëndetshëm kundrejt atij të pashëndetshëm.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, figura të ushqimeve të ndryshme, gërshtë, ngjitës			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Shkathësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja pyet nxënësit/et: <i>Cili është ushqimi juaj i preferuar?</i> Merr përgjigje nga disa nxënës/e dhe emrat e disa ushqimeve shkruhen në tabelë. Mësuesi/ja shpjegon që, si çdo gjallesë edhe njeriu ka nevojë për ushqim dhe që sot do të mësojnë më shumë rreth “Ushqimi dhe shëndeti”.			
HAPI II: Nxënësit/et hapin librat f.26 dhe njësia mësimore lexohet me zë nga disa nxënës/e. Mësuesi/ja pyet nxënësit/et për informacionet e reja, përmes pyetjeve të cilat i ka shkruar në tabelë apo i ka paraqitur përmes projektorit. - Cilat ushqime janë të shëndetshme? - Cilat ushqime nuk janë të shëndetshme? - Pse uji është i rëndësishëm për shëndetin? Pas marrjes së përgjigjeve nga nxënësit/et, diskutohen edhe figurat e paraqitura në libër, ku kërkohet nga nxënësit/et të tregojnë se, - Cili nga fëmijët është ushqyer shëndetshëm? Pse mendon kështu?			

HAPI III:

Mësuesi/ja zhvillon një bashkëbisedim me nxënës/e rreth ushqimeve të preferuara të nxënësve të shkruara më parë në tabelë, duke i klasifikuar ato në të shëndetshme dhe jo të shëndetshme.

Paraqet para nxënësve fleta A4 me figura të ushqimeve të ndryshme, duke u shpjeguar që këto figura do t'i presin dhe pastaj t'i klasifikojnë e vendosin në tabelë në vendin përkatës.

<i>Ushqime të shëndetshme</i>	<i>Ushqime jo të shëndetshme</i>

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet angazhimi i nxënësve në dhënien e përgjigjeve, plotësimi i tabelës

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.13

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Marrëdhëniet jetësore		Rezultati i të nxënimit të temës: Tregon nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të gjalla	
Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, 2; II.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Nevojat e gjallesave			
Fjalët kyçe: ujë, ajër, ushqim, strehim, ngrohtësi.			
Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
<i>identifikon pesë nevojat e gjallesave;</i> <i>tregon për tri gjallesat se si i plotësojnë nevojat e tyre;</i> <i>shkruan nga tri nevoja për secilin grup të gjallesave.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, plastelinë, letër, lapsa me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I:			
Mësuesi/ja prezanton njësinë e re mësimore duke shkruar titullin në tabelë “ Nevojat e gjallesave”, kërkon nga nxënësit/et të mendojnë dhe të tregojnë se cilat janë nevojat bazë të gjallesave, mendimet e tyre i shkruan në tabelë.			
Nevojat e gjallesave			
HAPI II:			
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që t'i hapin librat f. 20; f.24.			
Njëri nga nxënësit/et lexon fjalinë e parë, diskutohet rreth saj përmes pyetjes, Për çfarë kanë nevojë gjallesat?			
Nxënësi/ja tjetër lexon fjalinë e radhës, mësuesi/ja parashtron pyetjen, Si i plotëson njeriu nevojat e tij?			
Merren mendimet e nxënësve, vazhdohet leximi i fjalive nga nxënës/e të ndryshëm, parashtrohen pyetjet për nxënësit/et, Si i plotësojnë bimët nevojat e tyre? Po kafshët, si i plotësojnë nevojat e tyre?			
Merren mendimet e nxënësve plotësohen ato sipas nevojës.			

Kërkohet nga nxënësit/et të shkruajnë nga tri nevoja për secilin grup të gjallesave të paraqitura me figura në librin e tyre.

Lexohen nga tre nxënës/e nevojat e secilit grup.

HAPI III:

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që të modelojnë me plasteline nevojat e bimëve (ujë, ajër, dhe, diell) sipas modelit të paraqitur në figure të librit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi në dhënien e përgjigjeve, shkrimi i nevojave, modelimi i figurës

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.12

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut		Rezultati i të nxënit të temës: Përdorë fjalë konkrete për pjesët e trupit dhe funksionet e tyre	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Trupi im			
Fjalët kyçe: kokë, trung, gjymtyrë, shqisa.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - emërton saktë tri pjesët kryesore të trupit; - identifikon gjymtyrët dhe tri funksionet e tyre; - identifikon pesë shqisat dhe funksionin e tyre.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, skica e trupit, laps, etiketa.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja para nxënësve prezanton trupin e njeriut përmes posterit apo pjesë të marra në laboratorin e biologjisë. Bashkë me nxënësit/et emërtohen pjesët kryesore të trupit.			
HAPI II: Prezantohet faqja 28 e librit dhe lexohet me zë nga mësuesi/ja, shpjegohet funksioni i gjymtyrëve, pesë shqisat. Zhvillohet bashkëbisedim me nxënës/e mësuesi/ja përmes pyetjeve nxit nxënësit/et për informacionet e reja që kanë mësuar. - Cilat janë pjesët kryesore të trupit? - Përse na shërbejnë krahët dhe duart? - Përse na shërbejnë këmbët? - Sa shqisa kemi? Cilat janë ato? Kërkohet nga nxënësit/et që të plotësojnë tabelën e paraqitur në libër, ku duhet treguar pse na shërbejnë shqisat.			
HAPI III: Mësuesi/ja ka përgatitur etiketa në të cilat nxënësit/et do t'i shkruajnë emrat e pjesëve të trupit, pastaj ato do t'i vendosin në vendin e duhur të skica e trupit e cila po ashtu është përgatitur (vizatuar apo printuar) nga mësuesi/ja. Udhëzohen nxënësit/et që të veprojnë sipas fotografisë së paraqitur në libër.			

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve, plotësimin e tabelës dhe vendosjen e emrave të pjesëve të trupit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.14

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon ndryshimet trupore në mes dy gjinive	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,3; II.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Si ndryshon trupi im?			
Fjalët kyçe: ndryshim, gjinor, bel, gjinj, shpatulla, nofulla, zë.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>dallon tri ndryshime në trupin tonë;</i> - <i>identifikon ndryshimet gjinore, djem – vajza</i> - <i>shkruan tri ndryshime të gjinisë femërore dhe tri të gjinisë mashkullore</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori, letër, gërshërë, ngjitës.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Përmes projektorit mësuesi/ja paraqet një video të ciklit jetësor të njeriut. Pas shikimit të videos diskutohet me nxënës/e përmes pyetjeve: - <i>Çfarë vutë re te kjo video?</i> - <i>Si ndryshon njeriu gjatë viteve?</i> - <i>Po ju cilat ndryshime i keni vërejtur te vetja juaj gjatë këtyre dy viteve?</i> Merren përgjigjet e nxënësve, theks të veçantë i vihet pyetjes së fundit, ku vazhdohet me nënpyetje si: - <i>Si mendoni, a janë ndryshimet e njëjta si të djemtë ashtu edhe te vajzat?</i> Nga përgjigjet e kësaj pyetje, njoftohen nxënësit/et se këto ndryshime quhen <i>ndryshime gjinore</i> . Theksohet që te gratë ndodhin edhe ndryshime tjera, kërkohet nga nxënësit/et që të vëzhgojnë figurat 3 dhe 4 dhe diskutohet rreth tyre.			
HAPI II: Përmes projektorit, paraqitet faqja 30 e librit. Mësuesi/ja jep informacione të reja rreth ndryshimeve të të dy gjinive. Përmes pyetjeve diskutohen edhe figurat e paraqitura në libër për t'i dalluar sa më mire këto ndryshime. - <i>A janë të njëjta ndryshimet si te vajzat, ashtu edhe te djemtë? Pse?</i> - <i>Cilat ndryshime ndodhin te vajzat?</i> - <i>Cilat ndryshime ndodhin te djemtë?</i>			

Theksohet që te gratë ndodhin edhe ndryshime tjera, kërkohet nga nxënësit/et që të vëzhgojnë figurat 3 dhe 4 dhe diskutohet rreth tyre.

HAPI III:

Punohet veprimtaria, “Ndryshimet e trupit”

Udhëzohen nxënësit/et që ta presin letrën në formë të etiketave duke shkruar në to një ndryshim që ndodh gjatë rritjes. Etiketat t`i vendosin poshtë figurës së duhur në libër.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve, vendosjen e etiketave te figurat përkatëse

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.15

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut		Rezultati i të nxënit të temës: - Tregon tolerancë dhe mirëkuptim në situatë të ndjeshme	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: IV.3, V.6; VI.4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Sjellja e mirë na nderon			
Fjalët kyçe: respektoj, durim, mirëkuptim			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - identifikon ndjenjat e gëzimit dhe hidhërimit gjatë lojës me moshatarë; - tregon për raportet shoqërore duke u bazuar në ilustrim; - vlerëson sjelljen e mirë me një shembull konkret.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori, letër e bardhë, laps, penela, bojëra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë shqipe.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja fillon orën duke u parashtruar pyetje nxënësve: - Si ndiheni kur luani me shokët e shoqet tuaja? Marrim përgjigje nga disa nxënës/e duke zhvilluar bashkëbisedim me nënpyetje si: <i>Cilat shprehje të tij/saj ju pëlqejnë? Cilat jo? A ndiheni ndonjëherë të mërzitur gjatë lojës apo pas saj?</i> Nxënësit/et japin përgjigjet e tyre duke treguar edhe raste konkrete.			
HAPI II: Përmes projektorit paraqitet faqja e librit nr.34. Jepen informacionet se si duhet të sillemi me të tjerët. Diskutohen figurat e paraqitura në libër. Kërkohet nga nxënësit/et që të tregojnë raste kur ata kanë treguar durim, mirëkuptim, kur i kanë kërkuar të falur shokut apo shoqes. Si i respektojnë shokët e shoqet dhe të rriturit. Paraqitet figura e katërt nga libri dhe diskutohet rreth saj. Kërkohet nga nxënësit/et të tregojnë: Si ju duket sjellja e djalit? A po vepron drejt ai? Pse?			

HAPI III:

Punohet, *Pema e miqësisë*

Mësuesi/ja vizaton një pemë në një fletë A3. Kërkon nga nxënësit/et që të lyejnë pëllëmbën e dorës me bojë dhe ta mbështesin te fleta e bardhë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për mendimet gjatë diskutimit, angazhimi në formimin e pemës së miqësisë

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.17

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve.		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon gjendjen e lëvizjes së trupave nga gjendja e qetësisë me shembuj nga përditshmëria.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4; III.3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Lëvizja e trupave			
Fjalët kyçe: lëviz, qetësi, vendndodhje.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - identifikon lëvizjen e trupave nga një pikë në pikën tjetër; - dallon trupat në lëvizje dhe në qetësi në një mjedis të caktuar; - liston trupat që ndodhen në lëvizje apo qetësi pas vëzhgimit në natyrë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, bllok shënimesh, laps.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë shqipe.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja bën disa hapa brenda klasës. Pyet nxënësit/et: - Çfarë bëra unë? - A ndryshoi vendndodhja ime? Pas marrjes së përgjigjeve nga nxënësit/et, mësuesi/ja shkruan në tabelë: Disa trupa lëvizin. Për shkak të lëvizjes ata e ndryshojnë vendndodhjen.			
HAPI II: Lexohet njësia mësimore f.31 me ndalesa duke parashtruar pyetje për çdo pjesë. - Cilët trupa lëvizin? - Çfarë ndryshon trupi kur lëviz? - Kur trupat janë në qetësi? Diskutohet bashkërisht rreth këtyre pyetjeve dhe figurave të paraqitura në libër. Pranë figurave ku dallohen lëvizje udhëzohen nxënësit/et të shënohet shenja √.			

HAPI III:

Kërkohet nga nxënësit/et që të marrin me vete bllok shënimesh dhe laps. Nxënësit/et do të dalin në oborrin e shkollës dhe të vëzhgojnë rreth 5 minuta. Do të shkruajnë trupat, të cilët lëvizin dhe trupa që janë në qetësi. Pastaj, emrat e tyre t'i shënojnë në tabelë.

Trupa që lëvizin	Trupa që janë në qetësi

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve dhe plotësimin e tabelës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetje dhe detyra; Fletore pune f.20, f.18.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve.		Rezultati i të nxënit të temës: Gjen shembuj nga lojërat, për lëvizje nëpër rrugë të drejtë, rrugë rrethore dhe lëvizje lëkundëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.2; IV.5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Lëvizje të thjeshta			
Fjalët kyçe: lëvizje e drejtë, e lakuar, lëkundje, rrotullim.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>praktikon tri lloje të lëvizjeve me grup të caktuar të fëmijëve;</i> - <i>identifikon llojin e lëvizje sipas shembullit;</i> - <i>demonstron lëvizje përmes objekteve.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm, Shoqëria dhe mjedisi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja fillon orën duke përsëritur njësinë e kaluar dhe ua kujton nxënësve që disa trupa lëvizin. Fton te tabela tre nxënës/e. Në dysheme shkruan një vijë të drejtë në të cilën duhet të ecë nxënësi/ja A. Merr një karrige ku duhet të ulet dhe të lëkundet ngadalë nxënësi/ja B. Me nxënësin/sen C improvizon një vallëzim duke e rrotulluar. Pastaj nxënësve u parashtron pyetje - Çfarë bëri nxënësi A? - Çfarë bëri nxënësi B? - Çfarë bëri nxënësi C? Nxënësit/et japin përgjigjet e tyre dhe sqarohet që do të mësojnë më shumë rreth lëvizjeve të trupave.			
HAPI II: Lexohet njësia f. 40 nga nxënësit/et. Pas leximit diskutohen situatat e paraqitura në figura përmes pyetjeve. - Si lëvizin fëmijët me biçikleta? - Çfarë lëvizje bën topi? - Si po zbavitën vajzat? - Çfarë bëjnë fëmijët?			

Disa nga nxënësit/et japin përgjigjet e tyre. Diskutohen edhe figura 4 duke pyetur nxënësit/et.

Ku dalloni lëvizje të drejtë? Po rrotullim? Cila figurë tregon lëkundje?

Mësuesi/ja paraqet edhe raste të tjera për t'i demonstruar llojet e lëvizjeve (si p.sh. hedhja e topit në dysHEME, tërheqja e karriges para-pas, etj.)

HAPI III:

Udhëzohen nxënësit/et që të përzgjedhin disa objekte, t'i lëvizin dhe të tregojnë llojin e lëvizjes që bën duke e plotësuar tabelën e paraqitur në libër.

Objekti	Si lëviz?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit në dhënien e përgjigjeve, përcaktimin e saktë të lëvizjes së objekteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetje dhe detyra; Fletore pune f.21, f.19.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve.		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon shembuj të lëvizjes së trupave me rënie, ngritje, hedhje, shkelmim, shtyrje, tërheqje etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.3; IV.5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Lloje të tjera lëvizjesh			
Fjalët kyçe: rënie (bie), ngritje, shtyrje, tërheqje, hedhje, shkelmim.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>demonstron lloje të caktuara të lëvizjes me vetdëshirë;</i> - <i>shpreh përvojat praktike mbi lëvizjet e trupave të ndryshëm;</i> - <i>plotëson tabelën me të dhëna sipas ilustrimit.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm, Shoqëria dhe mjedisi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja rikujton disa lloje të lëvizjeve nga njësia e kaluar. Fton disa nxënës/e të dalin te tabela. Përmes pantomimës u kërkohet të demonstrojnë lëvizje të ndryshme dhe nxënësit/et tjerë e përcaktojnë llojin e lëvizjes.			
HAPI II: Udhëzohen nxënësit/et të vëzhgojnë ilustrimet në faqen 42 të librit. Diskutohet rreth secilës figurë. Mësuesi/ja lexon fjalitë poshtë secilës figurë. Kërkohet nga nxënësit/et përmes pyetjeve që të tregojnë rreth përvojave të tyre praktike që lidhen me llojin e lëvizjes. - Keni parë trupa tjerë që bien poshtë? Tregoni shembuj. - Cilët trupa tjerë ngrihen lartë? - Keni shtyrë ndonjë trup? Po tërhequr? - Çfarë ndodh me topin kur luani? Keni realizuar lëvizje të tilla gjatë lojës? Vëzhgohen edhe figurat e fundit ku nxënësit/et duhet ta përcaktojnë llojin e lëvizjes që bëjnë fëmijët.			

HAPI III:

Realizohet veprimtaria e paraqitur në libër. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et që të zgjedhin nga figura e paraqitur në libër disa trupa që lëvizin dhe plotësoni tabelën duke treguar se si lëvizin ata trupa.

Trupi	Si lëviz?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në përcaktimin e llojit të lëvizjeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.22, f.20.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve.		Rezultati i të nxënit të temës: Emërton trupa që lëvizin në tokë, në ujë dhe në ajër.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; V.2. VI.2			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ku lëvizin trupat?			
Fjalët kyçe: rënie (bie), ngritje, shtyrje, tërheqje, hedhje, shkelmim.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - identifikon kafshët sipas lëvizjes që bëjnë; - emërton lëvizjen e kafshëve bazuar në karta e memories; - përcakton vendin e lëvizjes së kafshëve dhe mjeteve të udhëtimit; - imiton lëvizjen e një kafshe të caktuar.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: poster, libri, 2 kuti, foto të kafshëve, të mjeteve te udhëtimit			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Përmes posterit, ku paraqiten kafshë të ndryshme, mësuesi/ja fillon orën duke u parashtruar nxënësve pyetje: - Si lëviz kjo kafshë? Ku lëviz/ec? Diskutohet rreth mënyrës së lëvizjes së kafshëve dhe vendit ku lëvizin. Si p.sh.: ec në tokë, zvarritet në tokë, fluturon në ajër, noton në ujë.			
HAPI II: Nxënësit/et hapin librat f. 44 dhe mësuesi/ja kërkon që të analizojnë fotografitë nga figura 1, diskutohet rreth tyre duke marrë mendime nga tre-katër nxënës/e. Diskutohen me radhë edhe fotografitë nga figurat 2 dhe 3. Ndërsa te figura 4, nxënësit/et duhet t'i plotësojnë etiketat me fjalët përkatëse ku tregohet se si lëvizin mjetet. Pastaj, nxënësve të ndarë në dy grupe u shpërndahen kutitë e fshehtësisë. Në njërin kuti mësuesi/ja vendos fotografi të kafshëve që lëvizin në mjedise të ndryshme; ndërsa në kutinë tjetër fotografi të mjeteve të udhëtimit. Fëmijët duhet t'i vendosin në vendin e caktuar në fletën flip chart e përgatitur nga mësuesi/ja ku janë të paraqitur uji, toka, ajri.			



HAPI III:

Mësuesi/ja njofton nxënësit/et që do të zhvillojnë lojën e imitimit të lëvizjes së kafshëve.

Secili nxënës do të për zgjedhë një kafshë dhe do të imitojë lëvizjen e saj. Nxënësit e tjerë do ta zbulojnë kafshën e imituar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve, për përcaktimin e saktë të vendit ku lëvizin trupat.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.23. f.21.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Trupat kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve.		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon dhe emërton trupa dhe gjallesa sipas shpejtësisë së lëvizjes së tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.3; V.2. VI.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Cili lëviz më shpejt?			
Fjalët kyçe: shpejt, ngadalë.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - praktikon lëvizjen e shpejtë dhe të ngadaltë; - dallon karakteristikat e kafshëve në figura sipas shpejtësisë së lëvizjes; - luan lojën sipas rregullave të caktuara.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori, figura kafshësh, figura të mjeteve të udhëtimit, lapsi.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm, Shoqëria dhe mjedisi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et që të dalin te tabela dhe të lëvizin sipas udhëzimeve. Mësuesi/ja thotë fjalën: ec. Nxënësit/et ecin. Pastaj fjalën: vrapo. Nxënësit/et vrapojnë. Pastaj u parashtron pyetjet: Kur lëvizët ngadalë? Po shpejt? Marrim përgjigje nga nxënësit/et dhe kalohet te faza tjetër: Cili lëviz më shpejt?.			
HAPI II: Udhëzohen nxënësit t`i hapin librat f.46. Diskutohet rreth figurave të paraqitura, jepen informacione rreth kafshës më të shpejtë dhe më të ngadaltë. Pasi të diskutojmë rreth figurave ku paraqitet trupi që lëviz shpejt dhe trupi që lëviz ngadalë. Përmes projektorit shfaqet një video rreth 3 minuta me kafshët më të shpejta në botë. https://www.youtube.com/watch?v=9IebRS6QbAE Pas shikimit të videos realizohet veprimtaria e paraqitur në libër “Shpejt apo ngadalë”. Mësuesi/ja u shpërndanë nxënësve figura kafshësh dhe mjete që lëvizin, udhëzohen që t`i grupojnë dhe pastaj ta plotësojnë tabelën.			

HAPI III:

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve që do të luajnë në çifte lojën “Shpejt-ngadalë”.

Njëri nxënës/e thotë një emër kafshe, tjetri fjalën shpejt ose ngadalë që tregon mënyrën si lëviz kafsha në fjalë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et për bashkëpunim dhe angazhim në aktivitete

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.24. f.22.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë.		Rezultati i të nxënësve të temës: Demonstron përfitimin e zërit nga burimet e ndryshme.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: I.1,3; III.2,3. VI.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Si prodhohet tingulli?			
Fjalët kyçe: tinguj, dridhen, burime tingulli, zukatje, zëri, përhapet.			
Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi/ja: - diskuton për krijimin e tingullit me dy-tri mendime; - identifikon pesë trupa që prodhojnë tinguj; - demonstroi prodhimin e tingullit me mjete konkrete.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, gota plastike, fije peri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et që të mbështesin kokën mbi bankë dhe të trokasnin ngadalë në bankë. Pyet nxënësit/et: - Çfarë dëgjuat? - Çfarë u krijua nga trokitja? - Si u ndiet gjatë këtij momenti? Marrim përgjigje nga disa nxënës/e; diskutohet rreth krijimit të tingullit dhe arrihet në përfundim që rreth nesh ka shumë trupa që lëshojnë tinguj.			
HAPI II: Hapen librat f.48 dhe bëhet leximi i njësive mësimore në paragrafë nga disa nxënës/e. Pas leximit përgjigjen në pyetjet e parashtruara nga mësuesi/ja në tabelë. Nga cilët trupa prodhohen tingujt? Si quhen këto burime? Si formon tingull mushkonja? Si lëshojnë zë gjallesat? Ku përhapet tingulli? Me anë të kujt e dëgjojmë tingullin?			

Nxënësit/et përgjigjen gojarisht në pyetjet e parashtruara. Tregojnë edhe shembuj të trupave të tjerë të cilët lëshojnë tinguj.

Njoftohen që ka edhe trupa të cilët nuk prodhojnë tinguj.

Diskutohet rreth figurave në libër dhe udhëzohen që të vendosin $\sqrt{\quad}$ pranë trupave që lëshojnë tingull.

HAPI III:

Realizohet veprimtaria, “Si përhapet tingulli?”.

Nxënësve në dyshe mësuesi/ja u shpërndanë dy gota plastike të cilat duhet t’i lidhin me fijen e perit dhe të flasin me njëri-tjetrin bazuar në figurën e paraqitur në libër.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet angazhimi në diskutim, në dhënie të përgjigjeve dhe realizim të eksperimentit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.25, f.23.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë.		Rezultati i të nxënit të temës: Emërton burimet e ndryshme të dritës të çfarëdo lloji.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Burimet e dritës			
Fjalët kyçe: dritë, burim drite, burime natyrore/artificiale, burime të drejtpërdrejta/të tërthorta.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>diskuton me dy tri mendime rreth dritës dhe burimeve të saj;</i> - <i>emërton pesë burime që lëshojnë dritë;</i> - <i>liston në tabelë trupa që bëjnë dritë dhe që nuk bëjnë dritë përmes ilustrimit.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fletore, laps, lapsa me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm, Shoqëria dhe mjedisi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja fillon orën duke shkruar fjalët kyçe në tabelë. dritë, burim drite, burime natyrore, burime artificiale Duke përdorur këto fjalë, nxënësit/et për 5 minuta do të shkruajnë dy apo tri fjali. Lexohen fjalitë nga nxënësit/et vullnetarë. Duke përdorur shkrimet e nxënësve mësuesi/ja në tabelë formon një hartë rreth dritës dhe burimeve të saj. Mësuesi/ja njofton nxënësit/et që do të mësojnë më shumë për burimet e dritës			
HAPI II: Nxënësit/et lexojnë njësinë mësimore f.50. Pastaj mësuesja u parashtron pyetjet: - Cilët trupa quhen burime drite? - Cilat janë burimet natyrore të dritës? - Cilat janë burimet artificiale të dritës? - Cilat janë burimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta? Marrim përgjigje nga nxënësit/et rreth këtyre pyetjeve. Diskutojmë rreth figurave të cilat janë burime drite dhe atyre të cilat nuk janë burime drite.			

Për të mësuar më shumë rreth burimeve të dritës dhe rëndësisë së tyre përmes projektorit paraqitet një video rreth 4 minuta.

What is Light Energy? Learn About Light Waves & Light Sources! *Science for Kids* - YouTube

HAPI III:

Realizohet veprimtaria e dhënë në libër. Nxënësit/et duhet të vizatojnë dhe ngjyrosin në tabelë trupa që bëjnë dritë dhe trupa që nuk bëjnë dritë.

Derisa nxënësit/et vizatojnë dhe ngjyrosin lëshohet kënga përmes “I see the light!”

I See the Light! - A Song about Light Sources - YouTube

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet angazhimi në shkrimin e përgjigjeve, pjesëmarrja aktive në dhënien e përgjigjeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.26, f.24.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Burimet e zërit, dritës dhe nxehtësisë në rrethinën tonë.		Rezultati i të nxënësve të temës: Tregon burime të nxehtësisë të jetës së përditshme, të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, III.2,3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Burimet e nxehtësisë			
Fjalët kyçe: dritë, burim drite, burime natyrore/artificiale, të drejtpërdrejta/ të tërthorta.			
Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi/ja: - identifikon katër burimet e nxehtësisë; - diskuton rëndësinë e burimeve të nxehtësisë nga videoja e shikuar; - ilustron katër burimet e nxehtësisë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori, fletë A4.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm, Shoqëria dhe mjedisi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja përmes projektorit paraqet fotografinë e Diellit.  Pyet nxënësit/et: <i>Përpos dritës, çfarë lëshon tjetër Dielli mbi Tokë?</i> Nxënësit/et japin mendimet e tyre dhe mësuesi/ja i plotëson me informacione shtesë, duke i njoftuar nxënësit/et se: <i>Dielli është edhe burimi më i madh i nxehtësisë.</i>			
HAPI II: Udhëzohen nxënësit/et të hapin librat f.52 dhe të lexojnë njësinë mësimore. Pas leximit mësuesi/ja parashtron pyetje: - Çfarë quhet burim nxehtësie? - Cilat janë burimet e nxehtësisë? - Përse përdoret gazi?			

Nxënësit/et japin përgjigjet e tyre dhe plotësohen me komente shtesë nga mësuesi/ja.

Për të mësuar më shumë rreth shfrytëzimit të burimeve të nxehtësisë, përmes projektorit shfaqet një video rreth 2 minuta.

Sources of Heat - YouTube

HAPI III:

Nxënësve u jepet nga një fletë e punës. Në njëërën kolonë do të shkruajnë emrin e një burimi të nxehtësisë, ndërsa në kolonën tjetër do ta vizatojnë atë burim të nxehtësisë.

Burim i nxehtësisë	Vizato

Pas përfundimit, disa nga nxënësit do të prezantojnë punën e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve dhe për plotësimin e fletës së punës

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetje dhe detyra, fletore pune f.27, f.25.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Mjedisi natyror		Rezultati i të nxënësve të temës: Përkthyer tokën si burim të mirave materiale	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: I.2, 7; II.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Toka ku jetojmë			
Fjalët kyçe: dhë, jetoj, të mira.			
Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
- përshkruan me tri karakteristika Tokën dhe rëndësinë e saj për jetën tonë; - liston katër të mira që marrim nga toka;			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fletorja, kub letre, projektori.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I:			
Nxënësit të organizuar në rreshta mësuesi/ja ua prezanton njësien e re mësimore, Toka ku jetojmë.			
Kërkon nga ta që të bëjnë një përfytyrim për temën. Pastaj nxënësit ua prezanton kubin dhe mënyrën se si do të punohet. Në faqet e kubit janë të shkruara kërkesat:			
përshkruaje (formën, ngjyrën);			
krahasoje (me çka është e ngjashme);			
shoqëroje (me ndonjë ngjarje nga jeta);			
analizoj (si është e ndërtuar, çfarë përmban);			
zbatoje (ç`na duhet, përse e përdorim);			
arsyetoje (pse është e rëndësishme).			
Pasi mësuesi/ja hedh kubin, nxënësit u jepet kohë që në mënyrë individuale të shkruajnë përgjigjet e tyre (me një apo dy fjali).			
Disa nga nxënësit/et lexojnë përgjigjet e tyre, krahasohen ato me mendimet e nxënësitve tjerë.			
HAPI II:			
Pastaj përmes projektorit paraqitet faqja e librit f.56, lexohet pjesa nga mësuesja dhe pas çdo paragrafi nxirren informacionet bazë dhe shkruhen në tabelë.			
Në shtresën e sipërme të Tokës rriten bimët.			
Kjo shtresë përmban dhe, ujë, ajër, gurë.			
Pa ushqim nuk mund të jetojmë.			
Disa kafshë ushqehen vetëm me bimë.			

Kërkohet nga nxënësit/et të përmendin disa kafshë që njohin të cilat ushqehen me bimë. Pas marrjes së përgjigjeve mësuesi/ja, së bashku me nxënës/e plotësojnë vendet boshe të figura në libër, ku duhet shkruar të mirat që marrim nga toka.

HAPI III:

Udhëzohen nxënësit/et që të rikthehen te përgjigjet e dhëna në fillim të orës dhe t'i plotësojnë ato me informacionet e reja që kanë marrë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në shkrimin e përgjigjeve dhe saktësisë së tyre

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punë praktike “Gjallesat rreth nesh”; Fletore pune f.28. f.26.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Dielli burim i jetës në tokë		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon për rolin e diellit, ajrit dhe ujit për jetën në tokë	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2 III.2, 3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Dielli, uji dhe ajri na japin jetë			
Fjalët kyçe: diell, ujë, ajër, jetë.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>shoqëron nëntë etiketat për të formuar drejt fjalinë;</i> - <i>argumenton me tre shembuj rëndësinë e diellit, ujit dhe ajrit;</i> - <i>ilustron rëndësinë e diellit, ujit dhe ajrit në përditshmëri.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fleta pune.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja fillon orën, duke iu shpërndarë nxënësve të organizuar në grupe, etiketa me fjalë për t'i radhitur ato që të formojnë fjalinë. Pa diell ujë dhe ajër, gjallesat nuk mund të jetojnë. Pasi nxënësit/et ta formojnë fjalinë, shkruhet në tabelë nga mësuesi/ja dhe diskutohet përmes pyetjeve: Pse mendoni që nuk mund të jetojmë pa diell? Po pa ujë e ajër? Marrim përgjigje nga nxënësit/et, prezantohet njësia e re mësimore.			
HAPI II: Nga tre nxënës lexohet njësia mësimore f.58 ndarë në paragrafë. Pas çdo paragrafi mësuesi/ja parashtron pyetje për nxënësit/et. - <i>Çka është Dielli? Si do të ishte pa dritën e tij? Po pa ngrohtësinë e tij?</i> - <i>Pse ajri është kaq i rëndësishëm për jetën tonë?</i> - <i>Çfarë do të ndodhte me bimët po të mos kishin ujë? Po kafshët a do të mund të jetonin pa ujë? Po njeriu?</i> Merren përgjigje nga nxënësit/et dhe diskutohet rreth tyre. Kërkohet nga nxënësit/et të vëzhgojnë figurat në libër diskutojmë dhe të plotësojnë se: Për çfarë e përdorin njerëzit ujin?			

HAPI III:

Nxënësve u shpërndahet fleta e punës ku është paraqitur tabela të cilën duhet ta plotësojnë me përgjigje dhe ilustrim.

	Rëndësia e tij	Ilustro
Dielli		
Uji		
Ajri		

Disa nxënës/e prezantojnë punën e tyre para klasës

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në formulimin e fjalisë, plotësimin e tabelës

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punë praktike: Përdorimi i ujit; Fletore pune f.29, f.27.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Mjedisi natyror		Rezultati i të nxënësve të temës: Përshkruan dallimin mes fushës, kodrës dhe malit.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: I.7; II.3; III.2; IV.5			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Njohim tokën ku jetojmë			
Fjalët kyçe: forma të relievit, mal, kodër, fushë.			
Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi/ja: - emërton saktë tri format e relievit: malin, fushën kodrën; - identifikon tri veprimtari që kryen njeriu në këto pjesë të Tokës; - krahason përmes punës praktike format e relievit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, plastelinë, lodra plastike.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja përmes projektorit ose fotografive të shtypura parqet format e relievit. Përmes pyetjeve nxit nxënësit/et që të emërtojnë-identifikojnë format e ndryshme të Tokës. E dini cila pjesë e Tokës është kjo? Po kjo? Merren përgjigjet e nxënësve, sipas nevojës plotësohen nga mësuesi/ja.			
HAPI II: Nxënësit/et fillojnë e leximin e njësive mësimore f.60. U kërkohet që pas çdo paragrafi të lexuar të ndalojnë për t'iu përgjigjur pyetjeve nga mësuesi/ja. Lexohet paragrafi i parë, nxënësit u parashtrahet pyetja: - Si quhen pjesët e ngritura dhe të ulëta të Tokës? Pas leximit të paragrafit dy parashtrohen pyetjet: - Pjesa më e ngritur e Tokës quhet? Si është në mal? Dhe pas leximit të paragrafit të katërt, vijon pyetja: - Po pjesët e sheshta të Tokës si quhen? Pas përgjigjeve të disa nxënësve rreth pyetjeve të parashtruara, vazhdohet me diskutimin për veprimtari të njeriu kryen në secilën prej këtyre pjesëve të Tokës. Identifikohen disa nga veprimtari, mësuesi/ja i shkruan në tabelë dhe udhëzon nxënësit/et që këto veprimtari t'i përshkruajnë në vendet boshe të libri i tyre.			

HAPI III:

Paraprakisht mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et që të marrin në klasë mjetet e punës si: plastelinë, lodra plastike (bimë, kafshë).

Nxënësit formojnë në mënyrë individuale, një mal të lartë apo edhe kodrën e fushën duke i bërë më të bukura me vendosjen e lodrave plastike pranë tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve, formimin e formave tokësore

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.30, f.28.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Mjedisi natyror		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon relievin, klimën, ujërat në tokë përmes vizatimit përkatësisht fotografive	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.2, 3; II.4;			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ujërat e Tokës			
Fjalët kyçe: lumë, det, liqen.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - gjen nga tri karakteristika për fjalët, lumë, det, liqen; - shkruan tri koncepte kyçe nga paragrafi I lexuar; - krahason ujërat e detyrave, lumenjve dhe liqeneve me tri argumente.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fletorja, fleta A4,			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe: lumë, det, liqen. Udhëzon nxënësit/et që për 5 minuta me këto fjalë të formojnë një fjali apo të tregojnë se çfarë dinë rreth tyre. Lexohen shkrimet e tre, katër nxënësve. Paraqitet njësia e re mësimore f.62.			
HAPI II: Teksti i ndarë në paragrafë lexohet nga mësuesi/ja. Nxënësve u jepet tabela e koncepteve apo e vizatojnë në fletoret e tyre, u kërkohet të lexojnë edhe një herë paragrafët dhe të plotësojnë tabelën me njohuritë e reja që do të marrin. U shpjegohet që tabela plotësohet pjesa 1.1 pas leximit të paragrafit të parë; 2.2 pas paragrafit të dytë dhe 3.3 pas leximit të paragrafit të tretë.			
	1	2	3
Lumi			
Liqeni			
Deti			
Gjatë kësaj kohe, nxënësit/et vëzhgohen dhe udhëzohen sipas nevojës, lexojnë disa nga nxënësit/et përmbledhjen e tyre.			

HAPI III:

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të vëzhgojnë figurat e paraqitura në libër dhe diskutohet se sa është i rëndësishëm uji i lumit, liqenit, dhe detit për jetën e njeriut. Diskutimi mund të nxitët përmes pyetjeve të parashtruara nga mësuesi/ja si:

- *Çfarë bëjnë fëmijët në figurën e parë? Po në të dytën?*
- *Ku ndryshon deti nga lumi?*
- *Si është uji i detit, i kripur apo i ëmbël?*

Shkruhen në tabelë disa nga konkluzionet e nxjerra.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në përgjigjet e nxjerra nga fjalë kyçe, plotësimin e tabelës së koncepte si dhe krahasimin e pjesë ujore

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punë praktike: Akvariumi me peshq; Fletore pune f.31, f.29.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Mjedis natyrorë		Rezultati i të nxënësve të temës: Identifikon ndotësit themelorë të mjedisit si: mbeturinat, fabrikat, automjetet, ujërat e zeza.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: I.1,2,3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndotësit e mjedisit			
Fjalët kyçe: mbeturina, ujëra të zeza, tym, fabrikë.			
Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi/ja: - identifikon katër ndotësit kryesor të mjedisit; - argumenton me tre shembuj konkret pasojat e ndotësve; - shkruan tri këshilla për një mjedis të pastër.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fletorja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë shqipe, Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et që të kujtojnë ditën kur në hapësirat e oborrit të shkollës evidentuam ndotjet e mjedisit. Nxënësit/et tregojnë disa nga gjetjet e tyre, diskutohet rreth tyre. Nxënësve u parashtrahet pyetja: - Cilët janë disa nga ndotësit kryesorë të mjedisit? Nga përgjigjet e nxënësve shkruhen disa nga ndotësit në tabelë si: mbeturina, ujëra të zeza, tymi. Paraqitet njësia e re mësimore, Ndotësit e mjedisit f.64.			
HAPI II: Udhëzohen nxënësit/et që t'i hapin librat, lexohet pjesa e parë nga një nxënës/e. Kërkohet nga nxënësit/et të japin mendime si si do të veprojë Drini në rastin e dhënë. Diskutohet rreth pyetjes: - Pse duhet t'i hedhim mbeturinat në kosh? Lexohet pjesa e dytë nga një nxënës/e tjetër, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et që të shikojnë figurat në libër dhe diskutojnë rreth tyre. Nxënësit/et nxitën në dhënie të përgjigjeve me anë të pyetjeve. - Çfarë e ndot tjetër mjedisin? - Si ndikon uji i ndotur te gjallesat? - Si ndikon ajri i ndotur te gjallesat? Merren përgjigje nga nxënësit/et diskutohet rreth tyre plotësohen nga mësuesi/ja sipas nevojës.			

HAPI III:

Kërkohet nga nxënësit/et që në dyshe të shkruajnë 3 këshilla për mbrojtjen e mjedisit. Pas përfundimit të punës disa nga nxënësit/et prezantojnë punën e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet bashkëpunimi për shkrimin e këshillave, angazhimi në dhënien e përgjigjeve

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.32. f.30.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Dielli burim i jetës në tokë		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan ndryshimin e klimës gjatë stinëve të vitit dhe krijimin e ditës dhe natës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.7; V.5; VI.2, VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Stinët e vitit			
Fjalët kyçe: stinë, verë, pranverë, vjeshtë, dimër			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
- përshkruan karakteristikat e katër stinëve të vitit; - bashkëpunon me të tjerët gjatë punës në grup; - modelon me materiale përkatëse njëzën nga stinët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, letër, gërshërë, ngjytës.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I:			
Mësuesi/ja organizon nxënësit/et në grupe me nga katër anëtar. Nxënësit/et brenda grupeve kanë numrat 1, 2, 3, 4.			
Njoftohen nxënësit/et me njësinë e re mësimore “Stinët e vitit” f.66.			
Mësuesi njofton nxënësit/et që: “Toka rrotullohet rreth Diellit. Gjatë këtij rrotullimi, rrezet e tij nuk e ngrohin Tokën njësoj nga të gjitha anët prandaj, formohen stinët e vitit: pranvera, vera, vjeshta, dimri”.			
Njoftohen nxënësit/et që pjesa është e ndarë në katër pjesë dhe secili do ta mësojë pjesën e tij, pra, njëshat janë përgjegjës ta mësojnë pjesën e parë e kështu me radhë. Fillohet leximi nga nxënësit/et u lejohet kohë 5 minuta.			
HAPI II:			
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et që të lëvizin 1-shat të ulen bashkë, 2-shat bashkë,..., dhe u shpjegon nxënësve që grupet e formuara tani quhen grupe të ekspertësh ndërsa grupet e më pasme grupe familjare.			
Udhëzon nxënësit/et që të fillojnë bashkërisht të mësojnë pjesën e caktuar (1-shat pranverën; 2-shat verën; 3-shat vjeshtën; 4-shat dimrin), të diskutojnë mes vete dhe të shkëmbejnë informacionet rreth materialit, brenda 10 minutave nxënësit/et do të kthehen në grupet familjare.			

Secili anëtar i grupit familjar, sipas radhës, shpjegon për të tjerët pjesën e vet. Mësuesi/ja vëzhgon grupet dhe udhëzon sipas nevojës

Pastaj nxënësit/et plotësojnë tabelën e paraqitur në libër.

Stina				
Si vishesh?				
Çfarë bën në këtë stinë?				

HAPI III:

Nxënësit/et udhëzohen që të grupohen prapë në grupe ekspertësh për ta modeluar stinën që ju përket.

Modelimin mund ta bëjnë bazuar në shembujt e dhënë në libër apo në ndonjë formë tjetër.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet bashkëpunimi në grup, dhënia e saktë e informacioneve

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f. 33, f.31.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: I	Klasa: II
Tema: Dielli burim i jetës në tokë		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan ndryshimin e klimës gjatë stinëve të vitit dhe krijimin e ditës dhe natës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.2			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Dita dhe nata			
Fjalët kyçe: ditë, natë, boshti i tokës.			
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - përshkruan formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet; - plotëson fjalët në fjali me konceptet e reja të bazuara në ilustrim; - demonstroi formimin e ditës dhe natës përmes mjeteve të punës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori, fletë pune, glob, elektrik dore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatë jetësore: Gjuhë shqipe, Arsimitimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
HAPI I: Mësuesi/ja fillon orën duke bërë përsëritje nga njësia e kaluar. - Si formohen stinët e vitit? Pas marrjes së përgjigjes dhe diskutimit të tyre, pyet nxënësit/et: - Po tjetër rrotullim a bën Toka? Presim përgjigje nga nxënësit/et për të kaluar te njësia e re mësimore, Dita dhe nata.			
HAPI II: Nxënësit hapin librat f.68 dhe përmes projektorit paraqitet faqja e librit në tabelë ku diskutohet rreth figurës së parë. Njësia mësimore lexohet me zë nga disa nxënës/e. Mësuesi/ja pyet nxënësit/et për informacionet e reja që kanë mësuar. - Pse ka ditë dhe natë? - Ku ndryshon dita nga nata?			

Vëzhgohet figura e katërt, diskutohet se çfarë paraqet dhe plotësohen vendet boshe me fjalët: ditë, natë. Mësuesi/ ja u shpërndan nxënësve fletën e punës ku do të plotësojnë fjalitë me fjalët ndihmëse.

ditë diellit ndriçuar Toka natë boshtit

_____ rrotullohet rreth _____ dhe _____ të saj.

Pjesa e _____ e Tokës është _____.

Pjesa e pandriçuar e Tokës është _____.

HAPI III:

Mësuesi/ja ka sjellë një glob dhe një ndriçues në klasë.

Praktikon para nxënësve formimin e ditës dhe natës, u sqaron që ndriçuesi është dielli dhe duke ndriçuar njërën pjesë të globit me ndriçues formojmë ditën ndërsa pjesa e pa ndriçuar mbetet natë.

Eksperimenti praktikohet edhe nga nxënësit/et.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve, plotësimin e fjalive, punën praktike

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune f.34, f.32.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHEN E ORËS MËSIMORE

TESTI I PARË VLERËSUES

Emri dhe mbiemri _____

Klasa: II ____

Pikët


1. Objektet rreth nesh përbëhen nga materiale të ndryshme.

(4 pikë)

Disa prej këtyre materialeve janë: _____, _____, _____, _____.

2. Ngjyros etiketën e duhur.

(4 pikë)



I fortë

I fortë

I fortë

I fortë

I lehtë

I lehtë

I lehtë

I lehtë

I rëndë

I rëndë

I rëndë

I rëndë

I thyeshëm

I thyeshëm

I thyeshëm

I thyeshëm

3. Plotëso fjalitë me fjalët: të ëmbël, të njelmët, djegëse, të thartë.

(4 pikë)

Torta ka shije _____.

Portokalli ka shije _____.

Djathi ka shije _____.

Qepa ka shije _____.

4. Lidh me shigjetë.

(2 pikë)

- Për pastrimin e trupit.



- Për pastrimin e mjedisit.



5. Uji gjendet në tri forma:
- i ngurtë, i lëngët, i gaztë.*

(2 pikë)

Këto forma quhen _____ të ujit.

6. Shëno në kutizë V (e vërtetë) ose G (e gabuar).

(2 pikë)

Uji mund të jetë *i ngurtë, i lëngët, i gaztë.*

Uji gjendet vetëm në tokë.

Akullnajat janë *i ngurtë.*Avulli është *ujë i lëngët.*

7. Përcakto formën e trupave të dhënë dhe ndaji në grupin përkatës.

(2 pikë)



Trupa të rregullt



Trupa të parregullt

8. Shëno V (e vërtetë) ose G (e gabuar).

(2 pikë)

Ajri përmban vetëm azot. _____

Pemët nuk e shtojnë oksigjenin në ajër. _____

Pa oksigjen, nuk mund të jetojmë. _____

Ajri i ndotur na dëmton shëndetin. _____

Pikët	0 -9	10 - 13	14 - 16	17 - 19	20 - 22
Vlerësimi	Arritje e pakënaqshme	Arritje minimale	Arritje të kënaqshme	Arritje shumë të kënaqshme	Arritje të shkëlqyera

TESTI I DYTË VLERËSUES

Emri dhe mbiemri _____

Klasa: II ____

Pikët

1. Rretho mjedisin, i cili dëmton jetën e gjallesave.

(1 pikë)



2. Lidh etiketat me fotografitë përkatëse.

(3 pikë)

tokë

ujë

ajër



3. Shëno V te veprimet e mira dhe X te veprimet e gabuara.

(2 pikë)


☐

☐

☐

☐

4. Nënvizto fjalët që tregojnë nevojat e gjallesave.

(2 pikë)

biçikletë

ujë

ajër

makinë

shtëpi

ushqim

5. Shkruaj ku duhet fjalët: **kafshët, bimët.**

(4 pikë)

_____ e përgatitin vetë ushqimin e tyre, duke përthithur ujin, ajrin, dritën dhe nxehtësinë e diellit.
 _____ e gjejnë të gatshëm ushqimin në natyrë.

6. Shëno V tek ushqimet dhe pijet e shëndetshme.

(2 pikë)


☐

☐

☐

☐

7. Në tabelën e mëposhtme, gjej fjalët e fshehura, të cilat tregojnë sjellje të mirë.

(4 pikë)

c	w	m	g	c	v	t	r	l	h
t	e	j	f	a	l	j	e	O	W
x	g	e	p	x	j	e	s	L	d
u	t	s	x	b	m	g	p	K	u
n	b	w	c	e	q	t	e	U	r
s	j	y	m	t	y	r	k	T	i
m	i	r	ë	k	u	p	t	l	m

Shkruaj fjalët që gjete: _____, _____, _____, _____.

8. Shëno me V (e vërtetë) dhe me G (e gabuar).

(4 pikë)

Pjesët kryesore të trupit të njeriut janë: koka, tringu, gjymtyrët. _____

Gratë kanë bel të hollë dhe lëkurë të butë. _____

Burrat i kanë shpatullat dhe nofullat më të ngushta se gratë. _____

Sytë, veshët, hunda dhe dora quhen shqisa. _____

Pikët	0 - 9	10 - 13	14 - 16	17 - 19	20 - 22
Vlerësimi	Arritje e pakënaqshme	Arritje minimale	Arritje të kënaqshme	Arritje shumë të kënaqshme	Arritje të shkëlqyera

TESTI I TRETË VLERËSUES

Emri dhe mbiemri _____

Klasa: II ____

Pikët

1. Lidh fjalët me figurat përkatëse.

(2 pikë)

Në qetësi

Në lëvizje



2. Rretho llojin e lëvizjes që kryen trupi?

(2 pikë)



a. lëviz drejt

b. lëvizje e lakuar

c. lëkundet

d. rrotullohet

3. Ngjyros figurën e objektit që tërhiqet.

(1 pikë)



4. Shkruaj mjedisin përkatës ku lëvizin këta trupa.

(4 pikë)










5. Lidh me shigjetë figurën me shpejtësinë përkatëse.

(3 pikë)



6. Rretho trupat që lëshojnë tinguj.

(2 pikë)



7. Shkruaj nga dy burime drite.

(4 pikë)

Burime natyrore	Burime artificiale

8. Plotëso fjalitë me fjalët e duhura:

(2 pikë)

Dielli, llamba, qiriri janë burime drite të _____.

Trupat që kthejnë dritën e burimeve të drejtpërdrejta, quhen burime drite të _____.

9. Cilët nga këta trupa janë burime të nxehtësisë? Shëno V.

(2 pikë)


☐

☐

☐

Pikët	0 - 9	10 - 13	14 - 16	17 - 19	20 - 22
Vlerësimi	Arritje e pakënaqshme	Arritje minimale	Arritje të kënaqshme	Arritje shumë të kënaqshme	Arritje të shkëlqyera

TESTI I KATËRT VLERËSUES

Emri dhe mbiemri _____

Klasa: II ____

Pikët

1. Rretho të mirat që marrim nga toka:

(2 pikë)



2. Lidh me shigjetë.

(3 pikë)

Shtresa e sipërme e Tokës përmban

bimë që rriten në tokë.

Njeriu e siguron ushqimin nga

dhé, ujë, ajër, gurë.

é

Disa kafshë ushqehen me

bimët dhe kafshët.

3. Shkruaj secilën fjali në kutizën e duhur.

(3 pikë)



Kodra është pjesë toke e ngritur,
por më e vogël se mali.

Fusha është pjesë toke e sheshtë.

Mali është pjesë toke shumë e ngritur.

4. Cilët janë ndotësit kryesorë të mjedisit?

(3 pikë)

_____, _____, _____.

5. Plotëso fjalitë me fjalët: *ajër, ngrohtësi, Dielli, ujë, dritë.*

(5 pikë)

a. _____ është një yll që ndriçon.

b. Ai i jep Tokës _____ dhe _____.

c. Pa diell, _____ dhe _____, gjallesat nuk mund të jetojnë.

6. Shëno me V (e vërtetë) dhe me G (e gabuar).

(2 pikë)

- a. Lumi është një rrjedhë uji e madhe dhe e përhershme. _____
- b. Uji i detit është i ëmbël. _____
- c. Liqeni është një pellg shumë i madh me ujë. _____
- d. Ujërat nuk i ndotin: ujërat e zeza, mbeturinat dhe tymi i fabrikave. _____

7. Lidh etiketat.

(2 pikë)

Kur Toka rrotullohet rreth Diellit

formohen stinët e vitit.

Kur Toka rrotullohet rreth boshtit të vet

formohet dita dhe nata.

8. Në tabelën e shkronjave janë fshehur fjalët, të cilat tregojnë stinët e vitit. Gjej fjalët.

(2 pikë)

D	H	J	E	v	O	N	I	L	N
S	I	P	R	A	N	V	E	R	A
M	D	T	Y	U	J	E	H	M	Y
B	Y	R	D	I	M	R	I	B	L
V	J	E	S	H	T	A	K	O	P

Pikët	0 - 9	10 - 13	14 - 16	17 - 19	20 - 22
Vlerësimi	Arritje e pakënaqshme	Arritje minimale	Arritje të kënaqshme	Arritje shumë të kënaqshme	Arritje të shkëlqyera

REFERENCA

- Korniza kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar), Prishtinë, 2016.
- Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (e rishikuar), Prishtinë, 2016.
- Kurrikula lëndore/programi mësimor për lëndën “Njeriu dhe natyra 2”, 2018.
- <https://www.dreamstime.com/>

